



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

REPUBLIC OF KOSOVO INDEPENDENCE E. PRISHTINE KOSOVA YANVAR 1978 / JANUARY 1978 STATISTICAL BUREAU			
5-0-06-2022			
05	47	1127	10

Nr. Prot.: 11461

Datë: 29/6/2022

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: Prof. Dr. Naser Sahiti, rektor i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"



N. Sahiti

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021

Nr.	Komponenta auditimit (kapitull)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet planifikuara për tu ndërmarr	Zyrtari/ët përgjegjës	Data planifikuar zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Çështja B1 - Mos regjistrimi i pronave në regjistrin e pasurive kapitale	Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6, pika 3 përcakton që - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK dhe të shpalosen në PFV tek neni: 19.3.1, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria” Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk është prezantuar në vlerën e plotë dhe të saktë, për faktin se regjistri i pasurive kapitale nuk ka përfshirë të gjitha pronat, që janë në shfrytëzim të UP-së, si në vijim: Objekti dhe parcela e Rektoratit të UP-së, kompleksi Universitar (objektet e Bibliotekës Kombëtare, Fakultetit Filozofik, Filologjik, Shkencave Natyrore dhe Edukatës fizike), kompleksi i Fakultetit Ekonomik, Juridik dhe Edukimit, kompleksi i Fakultetit të vjetër Teknik (seksioni i arkitekturës), dhe objekti i ri i Fakultetit të Bujqësisë Veterinarisë (FBV). Kjo çështje është trajtuar në raportet tona tashmë e disa vite më radhë. Ne e kemi sqaruar se	Rektori duhet të shtyjë punën e komisionit të mandatuar në ndërmarrjen e veprimeve dhe rezultateve konkrete për zgjidhjen e çështjes së pronësisë në mes UP dhe Komunës së Prishtinës për pronat të cilat janë në kontest, vlerësimin e këtyre pronave dhe evidentimin e tyre në regjistrat e saj më qëllim që të gjitha pasuritë kapitale që i takojnë dhe janë në shfrytëzim të UP-së të përfshihen në regjistrat e pasurive dhe të prezantohen në PFV.	Arsye e mosregjistrimit të plotë të pasurive mbi 1,000.00 euro është se ende nuk është zgjidhur çështja e pronave me Komunën e Prishtinës. Një pronë, e cila për titullar nuk e ka UP-në, është problem të futet në regjistrat e pasurive kapitale e pastaj të hiqet apo të bartet. Kjo çështje ka figuruar si e gjetur edhe në Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2020. Rektori i UP-së, më 7.12.2020, ka emëruar një komision profesional për identifikimin, vlerësimin dhe rivlerësimin e të gjitha pronave në shfrytëzim nga UP-ja. Ky komision ka filluar nismën për formimin e një grupi teknik për realizimin e matjeve gjeodezike, përpilimin e planeve kadastrale dhe elaboratin përkatës pronësor. Për përkrahjen e kësaj nisme, menaxhmenti ka kërkuar nga Këshilli Drejtues i UP-së ndarjen e	Menaxhmenti, ZKA dhe zyrtari i pasurisë	Me krijimin e mundësive për identifikimin e të gjitha pronave (orientimisht gjatë vitit 2023)	

		<p>mos evidentimi në regjistra i këtyre pronave kishte ndodhur për shkak të problemeve të pa zgjidhura pronësore në mes UP-së dhe Komunës së Prishtinës. Mirëpo, marrë parasysh faktin e kohëzgjatjes së këtij problemi, konsiderojmë se UP nuk ishte angazhuar mjaftueshëm në konkretizimin e punës së komisionit përkatës për zgjidhjen e kësaj çështje. Ndikimi Mos regjistrimi i të gjitha pronave në regjistrin e pasurisë reflekton mungesë të informatave mbi gjendjen e pasurisë dhe ndikon në prezantim jo të plotë të vlerës së pasurive në PFV.</p>		<p>mjeteve të nevojshme për vlerësimin dhe rivlerësimin edhe të pronave dhe objekteve të cilat janë ndërtuar deri në dyzet (40) ose pesëdhjetë (50) vite më parë.</p> <p>Siç është vënë në dijeni menaxhmenti i UP-së, ky komisioni ka hasur në probleme të shumta në realizimin e detyrave të tij, për shkak të mungesës së dokumentacionit, çështjes së pronësisë etj.</p> <p>Çështja e vlerësimit të objekteve dhe pasurisë kapitale është problem i njohur në të gjithë vendin, pasi nuk ka komisioni shtetëror profesional për këtë çështje.</p>			
2	<p>Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave</p>	<p>Sipas nenit 17.1 të Rregullores 01/2017 për PFV të OB, ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë, për mallrat dhe shërbimet e furnizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagesë nga organizata përkatëse buxhetore. Në tre raste të</p>	<p>Rektori duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh dhe porositja e mallrave apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur paraprakisht janë siguruar fondet apo</p>	<p>UP do të ndërmarrë të gjitha veprimet që në të ardhmen të mos ketë keqklasifikim të shpenzimeve dhe mosekzekutim të pagesave përmes vendimeve të gjykatave. Pagesa e realizuar nga Thesari është si rrjedhojë e moszbatimit të marrëveshjes nga ana e Ministrisë së Inovacionit</p>	<p>Rektori, ZKF dhe ZKA</p>	<p>Nga muaji qershor 2022</p>	

		<p>pagesave të testuara në vlerë 421,522€ , kemi vërejtur se faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Pagesa për "Mbeturina" me vlerë 5,188€, kishte 34 ditë vonesë, pagesa "Rregullimi i rrugëve ne FBV" me vlerë 100,119€ 171 ditë vonesë dhe pagesa "Furnizim me pajisje dhe materiale të ndryshme në Fakulteti i Injinerisë Mekanike FIM" me vlerë 316,214€ 53 ditë vonesë. Kjo praktikë ishte raportuar edhe në raportet e viteve të kaluara dhe si e tillë, po përsëritet vit pas viti për shkak të dobësive në kontrollet e brendshme sa i përket pagesës së faturave me kohë.</p>	<p>ndarë mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë</p>	<p>dhe shuarjes së kësaj ministrie. Ministrinë pasuese të cilat e kanë marr nën menaxhim Departamentin e Inovacionit nuk e kanë përfillur marrëveshjen, ndërsa UP-ja nuk ka pasur të planifikuara mjete për këtë destinim, prandaj edhe pagesa është realizuar përmes përmbartimit.</p> <p>UP-ja në vitin 2019 ka nënshkruar një marrëveshje tjetër me MMPH me qëllim të përmbushjes së obligimit sipas marrëveshjes dhe njëherësh rimbursimin e atyre mjeteve, mirëpo edhe këto marrëveshje nuk janë përmbushur. Gjithashtu, nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë kemi marr premtim për rimbursim të mjeteve, mirëpo kjo nuk ka ndodhur.</p> <p>Menaxhmenti do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që situata të ngjashme të mos përsëriten, respektivisht të mos shpallen tenderë në bazë të marrëveshjeve pa dëshmi për përmbushjen e</p>			
--	--	--	---	--	--	--	--

				obligimit nga subjekti tjetër që nënshkruan marrëveshje me UP-në.			
3	Çështja B3 - Keq klasifikim i shpenzimeve	Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 shpenzimet duhet të realizohen dhe të evidentohen në kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i Udhëzimi Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël kërkon nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. UP kishte bërë pagesa nga kategoritë jo adekuate që kishin rezultuar me keq klasifikime prej 195,285€, si në vijim: Në tetë raste keq klasifikimi prej 164,663€ kishte rezultuar nga pagesa e pajisjeve me vlerë më të madhe se 1,000€ nga mallra dhe shërbimet, derisa do të duhej të paguheshin nga investimet kapitale. Këto keq klasifikime ishin vërejtur tek kontratat : "Furnizim me pajisje për përpunimin e qumështit në FBV"; "Furnizim me pajisje" nga projekti GEOBIZ"; "Furnizim me pajisje";	Rektori duhet të sigurojë se me rastin e planifikimit të projekteve, bëhet një analizë e mirëfilltë e natyrës së shpenzimeve dhe ashtu që projektet të buxhetohen në përputhje me natyrën e shpenzimit, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV sipas standardeve të kontabilitetit dhe në përputhje me planin kontabël.	Menaxhmenti i UP-së ka ndërmarrë masa të menjëhershme që ky rekomandim të zbatohet dhe të përmirësohet planifikimi i buxhetit nga njësitë akademike në kodet ekonomike përkatëse dhe gjatë realizimit të buxhetit të mos ketë keqklasifikime.	ZKF, ZKA dhe zyrtari i zotimeve	Nga muaji janar 2022	

		<p>"Furnizim me llap top"; "Furnizim me pajisje elektronike nga projekti"; "Furnizim me pajisje elektronike për VR/AR"; "Furnizim me pajisje të TI"; "Furnizimi, instalimi dhe trajnimi për pajisje të laboratorit" ; "Renovime për Fakultetin e Ndërtimtarisë FN,Fakulteti i Injinerisë Elektrike-FIEK,FIM". Në dy raste të tjera, tek kontrata "Renovime për FN, FIEK dhe FIM" dhe kontrata " Furnizimi, instalimi dhe trajnimi për pajisjet e laboratorit në FIM", keq klasifikimi ishte në vlerë 30,622€ dhe kishte ardhur si rezultat i pagesës nga kategoria e investimeve kapitale, i shpenzimeve që i takojnë mallrave dhe shërbimeve. Kjo kishte ndodhur për shkak të analizës jo të mirë me rastin e planifikimit të projekteve.</p>					
4	<p>Çështja B4 - Mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit</p>	<p>Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm, vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Tek dosja e tenderit për kontratën "Drenazhimi, Kanalizimi,</p>	<p>Rektori duhet të sigurojë se me rastin e vlerësimit të tenderëve, komisioni i vlerësimit të marrë për bazë vetëm OE të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura me dosjen e tenderit në</p>	<p>ZKA në koordinim me ZPP-në kanë ndërmarrë të gjitha veprimet që tutje të mos ketë lëshime të tilla gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. UP do të sigurohet që në përbërje të komisioneve për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve, të ketë njohës të fushave</p>	<p>ZPP dhe ZKA</p>	<p>Nga muaji maj 2022</p>	

		<p>Ujësjiellësi në Filologjik, Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore-FSHMN „Filozofik” Lot 1-në vlerë 1,734,655 €”, në kuadër të kapaciteteve teknike dhe profesionale ishte kërkuar si kriter “polica e sigurimit nga kompanitë e licencuara të sigurimit që operojnë në RKS për vende punishte dhe palë të treta në vlerë 2,000,000€”. OE fitues, nuk kishte dorëzuar Polisën e sigurimit (kontratën specifike të përgatitur dhe të lëshuar nga siguruesi, për të mbuluar një rrezik specifik ose një numër të veçantë të rreziqeve sipas kushteve të përcaktuara), por vetëm një draft kontratë për aplikim të tenderit të lëshuar nga një kompani e sigurimit. Kjo kishte ndodhur për shkak se me rastin e vlerësimit të ofertave, komisioni i vlerësimit nuk kishte marrë parasysh kriteret e parapara me dosjen e tenderit.</p>	<p>mënyrë që të arrihen objektivat e parapara të projektit përkatës.</p>	<p>me të cilat ka të bëjë procedura e prokurimit. Përmes mekanizmave përkatës, do të sigurohemi që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në përputhje të plotë me legjislacioni e prokurimit publik dhe kriterëve të parapara në njoftimin për kontratë publike dhe dosjen e tenderit.</p>			
5	<p>Çështja A1 - Mbvlerësim i shpalosjeve të hyrave të bartura dhe shpenzimeve nga grantet në PFV</p>	<p>Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të prezantojnë Raporti Vjetor Financiar (PVF) sipas Rregullores nr. 01/2017 dhe të raportojnë sipas Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe</p>	<p>Rektori duhet të sigurojë që gabimet e identifikuara në pasqyra financiare të përmirësohen me kohë dhe të korrigjohen brenda afatit të lejuar ligjor</p>	<p>UP-ja ka përgatitur PVF për vitin e përfunduar më 31.12.2021 sipas shënimeve përfundimtare të SIMFK-së të datës 31.1.2022 dhe këto janë shpalosur në PVF, por pas kësaj date Thesari ka</p>	ZKF	<p>Me përpilimin e PFV-ve për vitin 2022</p>	

		<p>Përgjegjësitë. Nga krahasimi i shënimeve të SIMFK-së me pasqyrat vjetore financiare të UP për vitin 2021, ne kemi identifikuar gabime në lidhje me prezantimin e shpalosjeve në vijim: Tek neni 21 (Raport për të hyrat vetjake të pashpenzuara) - shuma e të hyrave e mbetur për bartje në 2022 është prezantuar vlera prej 250,930€ ndërsa do të duhej të ishte 247,151€. Ky zë është mbi deklaruar për 3,779€; Tek neni 24 (Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara) - shuma e e shpenzimeve të vitit aktual është prezantuar vlera prej 571,420€ ndërsa do të duhej të ishte 556,566€. Ky zë është mbi deklaruar për 4,314€;</p>	<p>në mënyre që PFV-të të prezantojnë gjendjen e saktë të të gjitha zërave.</p>	<p>harmonizuar shënimet dhe janë krijuar këto dallime. UP-ja do t'i rishikojë tani e tutje PVF-të dhe shënimet e SIMFK-së edhe pas datës 31 janar, dhe nuk do të ketë mosharmonizim të shifrave dhe do t'i respektojë rekomandimet sipas procedurave ligjore.</p>			
6	<p>Çështja B5 - Mangësi në procedimin e pagesave</p>	<p>Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, neni 22, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të mallit bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura. Në tre raste me vlerë 433,892€, urdhër blerjet ishin proceduar pas pranimit të faturës. Këto raste kishin ndodhur tek pagesat për sigurimin e objekteve, pastrimin e ndërtesave dhe furnizimin me pajisje dhe material të ndryshme në FIM.</p>	<p>Rektori duhet të forcoj kontrollet e brendshme, dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.</p>	<p>Menaxhmenti i UP-së ka ndërmarrë masa të menjëhershme dhe nga muaji mars 2022 ka filluar zbatimin e këtij rekomandimi.</p>	<p>Zyra e prokurimit dhe ZKF</p>	<p>Nga muaji mars 2022</p>	

		Kjo praktikë ishte raportuar edhe në raportet e viteve të kaluara dhe si e tillë, po përsëritet vit pas viti për shkak të dobësive në kontrollet e brendshme.					
7	Çështja A2 - Mos zhvillimi i procedurës së veçantë të prokurimeve	Sipas LPP-neni 28, specifikimet teknike, pika 2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Më tutje, njoftimi i AQP-së i datës 06.07.2021 dërguar autoriteteve kontraktuese specifikonte se, për furnizimet që janë pjesë e procedurave për të cilat AQP ende nuk ka lidhur kontratë, AK duhet të zhvillojë procedura një furnizimshe (jo kontratë kornizë). Tek procedura "Renovimet në UP"-në vlerë 68,224€ kemi vërejtur se, përveç renovimeve (punëve), kontrata përfshinte edhe furnizime me mobile dhe inventar. Për këto furnizime do të duhej të zhvillohej procedurë e veçantë një furnizimshe (jo kontratë kornizë) sipas udhëzimeve të AQP-së. Kjo kishte ndodhur si	Rektori duhet të vendos kontrolle efektive në fushën e prokurimit në mënyrë që procedurat e prokurimit të zhvillohen sipas rregullave në fuqi dhe duke respektuar rekomandimet e autoriteteve përkatëse.	UP ka nisur t'i identifikojë dhe t'i verifikojë të gjitha kërkesat e njësive kërkuese dhe ka ndërmarrë hapa konkretë në adesimin e kësaj të gjeture. Ndër masat, UP ka njoftuar kompaninë projektuese (për hartimin e paramasave dhe specifikacionit teknik), dekanët e njësive Akadematike, si dhe zyrën e financave, që të siguroheni se të tilla raste të mos përsëriten sërish. Megjithatë, kombinimi i procedurave të prokurimit për furnizim/shërbime/punë është i lejuar edhe me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik. Shih pikat 15.3 dhe 15.4! Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një kontratë që ka si qëllim kryesor kryerjen e punëve e që përfshinë shërbime profesionale të lidhura me ndërtimtari, të	Dekanët e njësive akademike, ZKA dhe ZPP	Gjatë vitit 2022	

		rezultat i mos respektimit të udhëzimeve të AQP-së, me rastin e inicimit të kësaj procedure të prokurimit.		domosdoshme për ekzekutimin e kontratës.			
8	Çështja B6 - Mos harmonizimi i raporteve të inventarizimit me regjistrin e pasurive	Sipas Rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19,pika 4.3 dhe 4.7, raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Komisionet e formuara në njësitë akademike për kryerjen e procesit të inventarizimit, nuk kishin bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jokapitale. Po ashtu nuk është përgatitë raporti i përgjithshëm i inventarizimit, por vetëm raporte individuale nga njësitë. Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos funksionimit të duhur të kontrolleve në fushën e menaxhimit të pasurive.	Rektori duhet të siguroj se pas kryerjes së procesit të inventarizimit, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të bëhet krahasimi në mes të gjendjes se inventarizuar dhe regjistrave të pasurisë në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV.	Menaxhmenti i UP-së do të ndërmarrë masa shtesë për sigurimin e zbatimit të këtij rekomandimi, duke filluar nga kujdesi i shtuar me rastin e formimit të komisioneve për inventarizim. Po ashtu, do të ndërmarrë masa të kontrollit gjatë dhe pas përfundimit të procesit të regjistrimit të pasurisë nga komisionet. Do të përpilohet raporti i përgjithshëm siç kërkohet me rregullore dhe presim të funksionalizohet platforma elektronike E-Pasuria nga organet kompetente të MAP-it.	Dekanët e njësive akademike, ZKA, ZKF dhe zyrtari i aseteve	Gjatë vitit 2022	